



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 6-18 MUAJSH **MUAJI MAJ**



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

Kuriozitete për muajin MAJ



Çfarë duhet të dimë për muajin Maj?

- Muaji Maj është muaji i buzëqeshjeve.
- Muaji Maj është muaji i biçikletave.
- Muaji Maj është muaji i fotografisë.
- Muaji Maj është muaji i luleshtrydhes.
- Në muajin Maj çelin luleboret, trëndafili dhe tulipani.

Muaji Maj-Tema: Format e argëtimit dhe lojërat

Grupi: 6-18 muajsh

- **Java I:** Format e argëtimit
- **Java II:** Lojërat me ngjyrat
- **Java III:** Lojërat me numrat
- **Java IV:** Programi për 1 Qershorin



Tema mujore: Format e argëtimit dhe lojërat




Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Format e argëtimit	Të njohim fëmijët me format e argëtimit. Disa elementë të rëndësishëm që ndikojnë pozitivisht në aspektin social dhe argëtues të jetës së tyre.	Java I
Lojërat me ngjyrat	Përsëritja e ngjyrave kryesore përmes punës së dorës dhe lojërave.	Java II
Lojërat me numrat	Përsëritja e numrave 1-3 dhe organizimi i aktiviteteve dhe lojërave me këta numra.	Java III
Programi për 1 Qershorin		Java IV




Shënim:

- Stafii edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim asimilimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët.
- Stafii edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.




Tema mujore: Format e argëtimit dhe lojërat



Tema e javës: Format e argëtimit			
Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Sporti dhe rëndësia e tij 	<p>Loja me top: Edukatorja mëson dhe ndihmon fëmijët të godasin me këmbë dhe me dorë një top të butë , “Hidh e prit topin”.</p> <p>Vjersha: “Topi im”</p> <p>Aktivitet: Krijimi i tunelit me rrathë. Edukatorja i ndihmon fëmijët të ecin këmba dorës nëpër rrathë.</p>	Një top,rrathë 
E Martë	Libri një mik i mirë i fëmijëve 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve libra të ndryshme me figura, i shfleton bashkë me ta dhe i emërtojnë së bashku.</p> <p>Loja: “Libri i ngjyrave”</p> <p>Aktivitet i lirë: “Këngë lëvizore”</p> <p>Aktivitet: Shtypim butonat e librave me muzikë dhe dëgjojmë tingujt e tyre.</p>	Mjete Didaktike Manuali i Lojrave “Ejani të luajmë” Libra me figura Libra me muzikë
E Mërkurë	Muzika dhe fëmijët 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja u tregon fëmijëve për muzikën, ninullat dhe këngët për fëmijë.</p> <p>Aktivitet: Rënia e veglave muzikore (lodra që ndodhen në grup).</p> <p>Aktivitet i lirë: Muzikë dhe kërcim</p> <p>Këngë: Lëvizore (sipas dëshirës)</p>	Libra me muzikë Lodra dhe vegla muzikore.

<p>E Enjte</p>	<p>Fëmijët dhe kërcimi</p> 	<p>Lojë e lirë: Edukatorët improvizojnë bashkë me fëmijët kërcime të ndryshme. Mund të imitohen lëvizje, ecje dhe kërcime.</p> <p>Këngë lëvizore: “A ram sam sam”.</p> <p>Aktivitet 2: Vendosja e rathëve në kon.</p>	<p>Manuali i Lojrave “Ejani të luajmë” Lodra</p>
<p>E Premte</p>	<p>Buzëqeshim së bashku</p> 	<p>Aktivitet: Identifikimi i buzëqeshjes përmes figurave</p> <p>Aktivitet i lirë: Lojë imituese dhe këngë lëvizore.</p> <p>Këngë: “Nëse ti që je i lumtur”</p>	<p>Libra me figura Manuali i Lojrave “Ejani të luajmë”</p> 

		Tema mujore: Format e argëtimit Tema e javës: Njohja me ngjyrat	
Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Ngjyra e kuqe 	Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve objekte me ngjyrë të kuqe dhe i ndihmon t'i emërtojnë. Vjersha: “Qershia” Lojë energjike: Loja me shami ose me top.	Sende me ngjyrë të kuqe ,top ,shami.
E Martë	Ngjyra e gjelbër 	Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve objekte me ngjyrë të gjelbër dhe i ndihmon t'i emërtojnë. Aktivitet: Ngjyrosje me gishta, ngjyra e gjelbër. Përralla: “Bretkosa”	Mjete Didaktike: bojra, letra A3, lodra me ngjyrë të gjelbër, Libri “365 rrëfenja para gjumit”. (f.74) 

<p>E Mërkurë</p>	<p>Ngjyra blu</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve objekte me ngjyrë blu dhe i ndihmon t'i emërtojnë. Aktivitet 1: Dalim në oborr dhe shikojmë qiellin dhe elementë të tjerë të natyrës. Aktivitet 2: Futja në kosh e lodrave me ngjyrë blu. Vjersha: “Ngjyrat e ylberit”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Lodra</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Ngjyra e verdhë</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve objekte me ngjyrë të verdhë dhe i ndihmon t'i emërtojnë. Vjersha: “Molla” Aktivitet: “Këngë lëvizore” Lojë energjike: “Me birila, me top”</p>	<p>Manuali i Vjershave Lodra, birila, top etj.</p>
<p>E Premte</p>	<p>Përsëritje e ngjyrave bazë të mësuara (blu, e kuqe, e gjelbër, e verdhë)</p> 	<p>Vjersha: “Ngjyrat e ylberit”. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrat që u njohën gjatë javës (blu, e kuqe, e verdhë, e gjelbër) dhe përsërit së bashku ato. Lojë energjike: Ngjitja e topave me ngjyra të ndryshme. Edukatorët vendosin një ngjitës midis dy karrigeve dhe fëmijët vendosin topat me ngjyra. Përralla: “Kutia e bojrave”</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete didaktike: skoç, topa me ngjyra Libri “365 rrëfenja para gjumit”. (f.34)</p>

		Tema e javës: Lojërat me numrat.	
Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Përsërisim numrat 1-3 	Vjersha: “Më gëzon në Maj ti mua”. Punë dore: Edukatoret ilustronë lojën me ngjyrimin me gishta. E ilustruar me foto. Vjersha: “1, 2, 3”. Këngë lëvizore: “Një elefant po kolovitet”.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike 
E Martë	Krijimi i krimbit me numra 1-3 	Vjersha: “Më gëzon në Maj ti mua”. Vjersha: “Lepuri”. Punë dore: Ngjitja e numrave tek krimbi i formuar nga rrahët me numra. Fëmijët, me ndihmën e edukatores, ngjisin numrat 1-3 sipas renditjes në fletën e vizatuar. Pas renditjes, së bashku me edukatoren, fëmijët emërtojnë dhe ngjyrat. Përralla: “Tri fluturat”	Mjete Didaktike: fletë me ngjyra, gërshërë, ngjitëse, fletë A4, lapsa me ngjyra.

<p>E Mërkurë</p>	<p>Numërojmë përmes shqisave</p> 	<p>Vjersha: “Këtu jam unë”. Aktivitet: “Numërojmë shqisat e arushit”. Edukatorja u tregon fëmijëve sa sy ka arushi, sa veshë, sa këmbë dhe sa duar. Fëmijët numërojnë pjesët e trupit të arushit me ndihmën e edukatores. Përrallë: “Brunoja, ariu bojëkafe”</p>	<p>Manuali i Vjershave Libri “365 rrëfenja para gjumit”. (f.74)</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Mësojmë të radhisim</p> 	<p>Vjersha: “Më gëzon në Maj ti mua” Loja e trenit: Loja zhvillohet në oborr. Vjersha: “Lepuri” Punë dore: Fëmijët në bashkëpunim me edukatoren radhisin lodra/sendet të çerdhes, etj. Edukatorja nxit të gjithë fëmijët të radhisin dhe emërtojnë deri në 3 sendet.</p>	<p>Mjete Didaktike: plastelinë, mbështjellëse/letra për, shkopinj druri, fletë me ngjyra.</p>
<p>Premte</p>	<p>Dita e Edukatores</p>	<p>Edukatores mendojnë vetë për aktivitetet që do të organizojnë.</p>	

Tema mujore: Format e argëtimit

Tema e javës: Përgatisim programin me vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit








Java IV

Rubrika

Aktivitetet

Mjetet e Punës

<p>E Hënë</p>	<p>Krijimi i kapelës</p> 	<p>Vjersha: “Topi im”.</p> <p>Bisedë: Edukatorja bisedon me fëmijët lidhur me festën e 1 Qershorit. Çfarë është Festa e 1 Qershorit? Çfarë bëjnë fëmijët gjatë festës së 1 Qershorit?</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”</p> <p>Kënga: “1 Qershori”</p> <p>Punë dore: Kapelet e 1 Qershorit. Edukatoret me fletë kartoni bëjnë kapele sipas ilustrimit në këtë material duke jua treguar fëmijëve.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: fletë kartoni të bardha ose me ngjyra.</p>
----------------------	---	---	--

<p>E Martë</p>	<p>Ngjyrosja ose zbukurimi i kapelës</p> 	<p>Vjersha: “Më gëzon në Maj ti mua”.</p> <p>Lojë energjike: Me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”</p> <p>Kënga “1 Qershori”</p> <p>Punë dore: Edukatorët ngjyrosin ose ngjisin topa me ngjyra tek kapelet. Mund të përfshihen edhe fëmijët për të shtuar ndonjë element.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: lapsa me ngjyra, fletë me ngjyra.</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Përgatisim programin me vjersha e këngë për festën e 1 Qershorit</p> 	<p>Vjersha: “Dallëndyshja”</p> <p>Përralla: “3 fluturat”</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”</p> <p>Kënga: “1 Qershori”</p> <p>Punë dore: Krijimi i fluturave sipas modeleve (edukatorët mund të zgjedhin modelin që dëshirojnë).</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete didaktike: lapsa me ngjyra, fletë A4.</p> 
<p>E Enjte</p>	<p>Përgatisim programin me vjersha e këngë për festën e 1 Qershorit</p> 	<p>Vjersha: “Tullumbace të kam xhan”</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”</p> <p>Kënga: “1 Qershori”</p> <p>Ngjyrosje/Punë dore: Krijojmë kartolinat për 1 Qershorin. Fëmijët ngjyrosin me ndihmën e edukatoreve lulet e pranverës si: luledielli, tulipanët, trëndafilat etj, duke krijuar një kartolinë për shokun/shoqen e grupit.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p>
<p>E Premte</p>	<p>Përgatisim programin me vjersha e këngë për festën e 1 Qershorit</p>	<p>Vjersha: “Ngjyrat e ylberit”</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”</p> <p>Kënga: “1 Qershori”</p> <p>Lojë e lirë</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p>